



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
PRIVREDNI SUD KOSOVA – COMMERCIAL COURT OF KOSOVO

---

**AD/GJKK.nr.05/2023**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Autoriteti Kompetent - Kryetari i Gjykatës Mahir Tutuli, duke vendosur sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga “S....” Sh.p.k., me seli në Kaçanik, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë F.B., bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 29.11.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore e ushtruar nga S.... ShPK, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komerciale – F.B., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

1. Gjykata Komerciale e Kosovës, përkatësisht Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate (autoriteti), më 17.10.2023, përmes postës elektronike (email zyrtar) ka pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në kompetencë ankesën e paraqitur më 17.10.2023 nga “S....” Sh.p.k., me seli në Kaçanik, për shqyrtim dhe vendosje lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e cila përcakton se personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtar lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek Autoriteti Kompetent, ndërsa në pikën 1.1, të të njëjtit paragraf thuhet se: *“Autoritetit Kompetent në këtë rast është Kryetari i Gjykatës Themelore në të cilën shërben gjyqtari, për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të atij gjyqtarit” dhe*

1.2 *“Kryetari i Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryetarit të Gjykatës se Apelit”.*

2. Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate më 06.11.2023, me aktvendimin e evidentuar si: AD.GjKK.nr.07/23, konform dispozitës së nenit 11 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka suspenduar procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit të Dhomës së Shkallës së Dytë F.B., e iniciuar nga parashtruesi i ankesës “S...” ShPK.

3. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), më 20.11.2023, me shkresën e evidentuar si: PSRK/RLN,nr,112/2023, ka njoftuar autoritetin e gjykatës se PSRK nuk ka iniciuar asnjë procedurë penale bazuar në parashtrësën e paraqitësit “S...” ShPK, dhe ndaj të njëjtit gjyqtar nuk është duke u zhvilluar procedurë penale apo ndonjë çështje tjetër penale.

4. Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate duke vepruar konform nenit 11 paragrafi 2 dhe mbështetur në dispozitën e paragrafit 5 të nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka shqyrtuar ankesën e paraqitësit S.... për iniciimin e procedurës Disiplinore.

5. Në ankesën për iniciim të procedurës disiplinore, parashtruesi i kërkesës “S...” Sh.p.k., ka kërkuar nga autoriteti kompetent i gjykatës të iniciojë procedurë disiplinore ndaj anëtares së komegjtit – gjyqtarit F.B., me pretendimin se e njëjta me rastin e vendosjes në çështjen juridike administrative – konfliktit administrativ të evidentuar në Dhomat e Shkallës së Dytë si: Kom.Dh.shk.II.nr.801/2023, nga paditësi/propozuesi “S...” Sh.p.k., kundër kundërshtarit së propozimit – të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, , me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, PSh.nr.144/23, datë 19.04.2023, ka bërë shkelje ligjore duke theksuar se: *“Gjykata e shkallës së dytë përmes Aktvendimit të lartëcekur ka dështuar që të sigurojë vendosje të drejtë, zbatim të ligjit, profesionalitet, paanshmëri, transparencë dhe pavarësi në vendimmarrje, duke nxjerrë vendim në kundërshtim me provat dhe dëshmitë”.* Ka pretenduar se me këtë aktvendim gjykata ka tejkalar kompetencat për vendosjen e këtij rasti duke u lëshuar në trajtimin dhe pretendimet e padisë sipas paditësit dhe jo pretendimeve për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Poashtu ka theksuar se kolegji me rastin e arsyetimit të këtij vendimi nuk ka marr për bazë as pretendimet e propozuesit, duke tentuar që të paraqes gjendje jo reale me pretendime të pavërteta.

6. Autoriteti kompetent bazuar në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka kërkuar nga anëtarja e kolegjit – gjyqtari F.B., deklaratë me shkrim lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore.

Në deklaratën me shkrim të datë 24.10.2023, gjyqtari F.B., ka thënë se pretendimet e paraqitura në ankesën për iniciimin e procedurës disiplinore, janë të pabazuara në fakte dhe prova: *“Lidhur me aktvendimin nr. Kom.Dh.shk.II.nr.801/23, konsideroj se pretendimet e personit të interesuar, gjegjësisht “personit të tretë” janë të pabazuara në fakte dhe prova dhe si të tilla janë të paqëndrueshme dhe tendencioze sepse “personi i interesuar” me asnjë fakt të vetëm nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij por thjesht është bazuar vetëm në insinuata të tija personale, të cilat nuk janë të bazuara, gjithashtu thekson se gjyqtarët në përbërje të kolegjit kanë vendosur në bazë të provave dhe në bazë të bindjes së lirë të gjyqtarit pa kurrfarë presioni apo ndikimi nga kushdo qoftë”*.

7. Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me pretendimet si më lartë, deklaratën e gjyqtarit F.B., njoftimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës të datë 20.11.2023, si dhe shkresat e tjera të lëndës gjeti se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore është e pabazuar. *“Autoriteti Kompetent sipas nenit 9 paragrafi 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 paragrafi 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore ose është parashkruar...”* – neni 9 paragrafi 6 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

8. Autoriteti i gjykatës vlerëson se në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, pretendimet e paraqitura, janë pretendime të natyrës së shkeljeve procedurale të cilat mund të atakohen në procedura gjyqësore, por të njëjtat nuk përbejnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

9. Rrjedhimisht, nuk mund të konstatohet se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore apo të ketë vendosur me subjektivizëm, dhe nuk mund të konkludohet se gjyqtari ka bërë shkelje gjatë trajtimit të rastit, andaj të njëjtat mbeten në nivel të supozimeve dhe si e tillë ankesa e paraqitur nuk përmban elementet e përcaktuara dhe informata bindëse se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, pasi pjesa e pretendimeve në ankesë i referohet sqarimeve të dispozitave ligjore apo shkeljes së tyre me rastin e marrjes së vendimit, udhëzimeve se si do duhej të vlerësoheshin provat dhe fakteve dhe në asnjë rast nuk paraqiten pretendime apo rrethanat të cilat mund të mbështeten në fakte dhe prova për shkelje të supozuar nga ana e gjyqtarit, me qëllim të iniciimit të procedurës disiplinore, andaj

pretendimet për shkelje procedurale mund të atakohen në procedura gjyqësore, por nuk përbejnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

10. Bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti kompetent ka gjetur se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore, dhe si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**AD/GJKK.nr.05/2023**

**Datë 29.11.2023**

Mahir Tutuli

---

Kryetar i Gjykatës Komerciale

Iu dërgohet:

- “S....” Sh.p.k – Parashtruesi i kërkesës
- Albert Zogaj – Kryesues i KGjK
- Avokati i Popullit
- F.B.. – Gjyqtar i Gjykatës Komerciale